

**Bislmi emërohet
udhëheqës i Zyrës për
Eksptizë, Zbatim dhe
Mbikëqyrje Strategjike**



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA TAKUAR TË HËNËN EDHE LIDERIN E LDK-SË, LUMIR ABDIXHIKU, NË LIDHJE PËR ÇËSHTJEN E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT TË RI ■ FAQE 4-5

ENDE PA PAJTIM PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT, RREZIK PËR ZGJEDHJE TË REJA NË KOSOVË?



Kanë mbetur vetëm edhe dhjetë ditë nga koha kur Kuvendi i Kosovës duhet ta zgjedhë presidentin apo presidentin e ri të vendit në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e reja të jashtëzakonshme parlamentare. Presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se dëshiron

të kandidojë edhe për një mandat pesëvjeçar por, në këtë fazë, ende asnjë nga subjektet politike nuk kanë folur hapur nëse do ta mbështesin kandidaturën e saj. PDK-ja dhe LDK-ja kanë kërkuar konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri

TË KUJDESESH DHE TË PAGUASH: BARRË E DYFISHTË PËR FAMILJARËT E PACIENTËVE NË QKUK F. 5



DIALOGU ME SERBINË NËN UDHËHEQJEN E MPJD-së F. 3



ÇFARË TREGOJNË VËREJTJET E FMN-së NGA MISIONI DYJAVOR MBIKËQYRËS NË KOSOVË? F. 7

Shkruan: Avdullah HOTI

ARRESTOHET ARTAN GRUBI PAS MË SHUMË SE NJË VITI NË ARRATI F. 2

KOSOVË - SHQIPËRI - MAQEDONI E VERIUT: THEKSOHET ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË PËRPARIMIN E AGJENDËS SË INTEGRIMIT EVROPIAN F. 6

EKONOMI



ODA EKONOMIKE BRITANIKE: MASAT URGJENTE, TË NEVOJSHME NË SEKTORIN E MINIERAVE NË KOSOVË F. 8

AKB: 22 % INTERES PËR FAMILJET, 16 % PËR BUQIT, A ËSHTË KJO MBËSHTETJE APO FAJDE E HAPUR FINANCIARE? F. 8

SPORT



DRITA SHFRYTËZON HUMBJET E BALLKANIT DHE PRISHTINËS, MERR KREUN NË TABELË F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ARRESTOHET ARTAN GRUBI PAS MË SHUMË SE NJË VITI NË ARRATI

SHKUP, 23 SHKURT - Ish-zëvendëskryeministri maqedonas Artan Grubi është arrestuar më 23 shkurt në pikën kufitare Bllacë, pas më shumë se një viti prej kur ishte në arrati, ka konfirmuar Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut. Grubi dyshohet për abuzim të detyrës zyrtare në rastin e njohur si “Lotaria Shtetërore”. Në këtë rast përfshihet edhe Përparim Bajrami, i cili, po ashtu, përmendet në aktakuzë si i dyshuar. Prokurorët dyshojnë se ata kanë përvetësuar rreth 8 milionë euro përmes prokurimit të pajisjeve të terminaleve të lotarisë elektronike (VLT). Autoritetet nuk kanë bërë me dije ende nëse Grubi do t’i

nënshtrohet masës së paraburgimit apo do t’iu dorëzohet autoriteteve gjyqësore më vonë gjatë ditës. Prokuroria pati kërkuar ndalimin e Grubit dhe Bajramit, me arsyetim se ekziston dyshim i bazuar se veprimet e të dyve kanë pasur qëllim përfitimin e paligjshëm material. Më 17 dhjetor të vitit të kaluar Prokuroria Penale pati kërkuar paraburgim prej 30 ditësh për Grubin dhe Bajramin dhe po atë ditë autoritetet maqedonase patën lëshuar urdhër-arrestim ndërkombëtar për të dyja figurat. Artan Grubi pati thënë përmes një postimi në “Facebook” se nuk po arratiset mirëpo që ishte në një vizitë private në Kosovë dhe që do të kthehej në



shtëpi. Ditën pas asaj deklarate, policia ka kërkuar në dy lokacione mirëpo nuk e ka gjetur atë. Kryeministri maqedonas Hristjan Mickoski pati thënë atëbotë se Grubi “bashkë me një person tjetër, biznesmen, është larguar nga Maqedonia [e

Veriut] me makinë me targa diplomatike dhe është nisur drejt vendit fqinj Kosovës” dhe që Bajrami, sipas tij, nuk ka qenë brenda territorit maqedonas për kohë të gjatë. Mes të tjerash, Grubi është futur në listën e zezë të Departamentit Amerikan të

Shtetit më 9 dhjetor, për shkak të, siç është thënë, përfshirjes në korrupsion, për ndërhyrje politike dhe përpjekje për ta mashtruar gjyqësorin. Arsyetimi për përfshirje në këtë listë ishte sepse ata kanë marrë ryshfet për të ndikuar në procedurat gjyqësore që lidhen me dënimin penal të ish-drejtorit të Administratës së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (DSK), Sasho Mijalkov, në rastin “Target” të hapur nga Prokuroria Speciale Publike (PSP), i cili kishte të bënte me përgjimet masive. Grubi ishte anëtar i Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI) të opozitës, dikur deputet dhe zëvendëskryeministër në qeverinë e mëparshme të LSDM-së dhe BDI-së.

SHËRBIMI SEKRET AMERIKAN E VRET NJË BURRË QË PO TENTONTE TË HYNTE JASHTËLIGJSHËM NË PRONËN E TRUMPIT

UASHINGTON, 23 SHKURT - Shërbimi Sekret i Shteteve të Bashkuara tha të dielën se agentët e tij e kanë qëlluar për vdekje një burrë të armatosur që kishte shkelur perimetrit e sigurisë të pronës së presidentit Donald Trump, Mar-a-Lago, në Florida. Trumpi ndodhej në Uashington në momentin e incidentit, i cili, sipas zyrtarëve, ndodhi rreth orës 1:30 të mëngjesit sipas kohës lokale. Agentët e Shërbimit Sekret

hapën zjarr ndaj një burri pasi e panë atë “duke hyrë në mënyrë të paligjshme në perimetrit e sigurisë në Mar-a-Lago herët në mëngjes”, tha zëdhënësi i agjencisë, Anthony Guglielmi, në një postim në X. I dyshuari, rreth 20 vjeç, “u vërejt pranë portës veriore të pronës Mar-a-Lago duke mbajtur atë që dukej si pushkë dhe një bidon me karburant”, thuhej në deklaratën e agjencisë. Agentët u përballën me burrin dhe e qëlluan. Asnjë oficer



amerikan nuk u plagos, ndërsa agjencia tha se në atë kohë në Mar-a-Lago nuk kishte “persona nën mbrojtjen e Shërbimit Sekret”.

I dyshuari u shpall i vdekur. Trumpi, i cili shpesh i kalon fundjavat në Mar-a-Lago, ka qenë cak i disa komplotëve apo tentativave për atentat. Në fillim të këtij muaji, Ryan Routh, 59 vjeç, i cili kishte planifikuar ta vriste presidentin në një fushë golfi në Florida në shtator 2024 dy muaj para zgjedhjeve amerikane, u dënua me burgim të përjetshëm. Sulmi i planifikuar nga Routh kundër Trump erdhi dy muaj pas një tentative për atentat ndaj

liderit republikan në Pensilvani, ku 20-vjeçari Matthew Crooks qëlloi disa herë gjatë një tubimi. Njëri prej plumbave ia gërvishi veshin e djathtë Trumpit. Crooks u qëllua dhe u vra menjëherë nga forcat e sigurisë dhe motivi i tij mbetet i panjohur. Incidenti ishte më i fundit në një seri episodesh të dhunës politike në Shtetet e Bashkuara. Emri i të dyshuarit në incidentin e së dielës nuk është bërë publik, ndërsa zyrtarët po përpiqen të kontaktojnë familjarët e tij.

ISLANDA PLANIFIKON REFERENDUM PËR NË BE, SIGURIA DHE PRESIONET GJEOPOLITIKE SHTYJNË RIFILLIMIN E NEGOCIATAVE



REYKJAVIK, 23 SHKURT - Qeveria e Islandës po shqyrton mundësinë e një referendumi për të rifilluar negociatat e pranimit me Bashkimin Evropian, me votimin që mund të zhvillohet që në gusht 2026, sipas informacionit të raportuar nga Politico. Ky hap vjen ndërsa Islanda përballet me presione të rritura gjeopolitike dhe shqetësime lidhur me vendimet dhe

deklaratat e presidentit të ShBA-së Donald Trump, veçanërisht për tarifat ndaj Islandës dhe diskutimet mbi aneksimin e Grenlandës. Koalicioni qeverisës ishte zotuar të mbante një referendum deri në vitin 2027, por zhvillimet e fundit duket se kanë përsheptuar agjendën. Parlamenti islandez pritet të shpallë datën e referendumi në

javët e ardhshme. Nëse qytetarët miratojnë rifillimin e bisedimeve, Islanda mund të avancojë në rrugën drejt anëtarësimit, duke kaluar vende të tjera kandidate nën kushte të caktuara. Debatet për zgjerimin e BE-së po fiton vulltë të ri. Komisioni Evropian po punon për një plan që mund t’i ofrojë Ukrainës statusin e anëtarësisë së pjesshme vitin e ardhshëm,

ndërsa Mali i Zi ka mbyllur së fundmi një kapitull tjetër negociues. Islanda aplikoi për anëtarësim në vitin 2009 gjatë një krize financiare të rëndë që çoi në falimentimin e tre bankave kryesore të vendit. Negociatat u ngrinë në vitin 2013 dhe në vitin 2015 qeveria kërkoi që Islanda të mos konsiderohej më si vend kandidat.

Australia mbështet heqjen e Andrewit nga linja mbretërore e trashëgimisë

CANBERRA, 23 SHKURT - Kryeministri i Australisë i ka thënë Sir Keir Starmer se qeveria e tij do të mbështesë planet për të hequr Andrew Mountbatten-Windsor nga linja e trashëgimisë mbretërore.

Anthony Albanese shprehu mbështetjen e tij për një propozim të tillë në një letër drejtuar kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar, shkruan BBC. Andrew, vëllai i Mbretit, mbetet i teti në radhë për fronin

pavarësisht se iu hoqën titujt e tij, përfshirë atë të “princit”, në tetor, për shkak të presionit për lidhjet e tij me financuesin pedofil Jeffrey Epstein. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar po shqyrton futjen e legjislacionit

për ta larguar atë nga linja e trashëgimisë. Kjo vjen pas arrestimit të Andrew të enjten, nën dyshimin për sjellje të keqe në detyrën publike. Ai ka mohuar vazhdimisht dhe me forcë çdo shkelje.



VETERANËT E UÇK-së JASHTË KËSHILLIT SHTETËROR PËR 28-VJETORIN E EPOPESË SË UÇK-së KRIJOJNË NJË PARALEL

PRISHTINË, 23 SHKURT - Me rastin e shënimit të 28-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Qeveria e Kosovës të premten ka miratuar themelimin e Këshillit Shtetëror për këtë përvjetor. Në këtë Këshill nuk janë përfshirë kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së. Si rrjedhojë, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, së bashku me kategoritë e tjera, ka themeluar këshillin organizues për organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve përkujtimore dhe ceremoniale në kuadër të kësaj ngjarjeje historike. Sipas OVL-së, edhe në rast se do të kishin marrë ftesë nga Qeveria e Kosovës nuk do të merrnin pjesë për shkak të, siç thonë, fyerjeve dhe moskujdesit ndaj tyre për gjashtë vjet me radhë. Nënkrjetari i OVLUÇK-së, Gazmend Syla, tha për "KosovaPress" se ishin të

obliguar të krijonin këtë këshill në mënyrë që të mos mbesin jashtë organizimeve. "Meqenëse ne nuk u përfshimë në këshillin shtetëror që e krijoi Qeveria e Republikës së Kosovës, në njëfarë forme u obliguam si shoqata të dala nga lufta, që të kemi kujdes të veçantë në këto ditë historike. Prandaj e kemi menduar që edhe ne të krijojmë një këshill, në këtë rast me disa personalitete, domethënë që kanë kontribuar, në fakt janë edhe themelues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pastaj luftëtarë të UÇK-së. Sigurisht që emrat e tyre janë më shumë ndoshta për simbolikën e tyre, për aktivitetin e tyre që e kanë pasur për çlirim të vendit", tha Syla. Ai u shpreh se organizimet do të ishte e rëndësishme të bëheshin së bashku me institucionet, ani pse është e papranueshme për ta që të



marrin pjesë në një vend ku anëtare është Mimoza Kusari-Lila që kishte kërkuar largimin e veteranëve nga rritja e pagës minimale apo fyerjeve të tjera nga pjesëtarë të qeverisë, përfshirë edhe kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Syla tha se të njëjtët duhet të kuptojnë se në karriget ku ata ulen sot, është ndërtuar mbi sakrificat e çlirimtarëve. Ai kërkon një reflektim nga ana e institucioneve shtetërore. "Do

të ishte tepër e rëndësishme që këto organizime të bëhen së bashku, edhe shoqatat e dala nga lufta, edhe qeveria, po qoftë edhe presidenca. Fatkeqësisht po bëhen gjashtë vjet që ne nuk kemi fare komunikim me institucionet tona", tha Syla. Nënkrjetari i OVL-së përmendi edhe agjendën e tyre për 5, 6 dhe 7 mars, e cila pritet të propozohet këtë javë në mbledhjen e këshillit.

Në Këshillin Shtetëror për shënimin e 28-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në krye do të jetë ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, bashkëkryesues ministri i Familjes dhe Mbrojtjes së Vlerave të Luftës, Andin Hoti, kurse anëtar kryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku. Ndërsa Këshilli Organizues i Kategorive të Dala nga Lufta do të përbëhet nga kryetari i OVLUÇK-së Hysni Gucati, Fadil Shurdhaj, Xhavit Jashari, Ali Ahmeti, Shefket Musliu, Sokol Poga, Agim Çeku, Lahi Brahimaj, Shukri Buja, Ahmet Isufi, Rahman Rama, Nuredin Lushtaku, Abdyl Mushkolaj, Latif Gashi dhe Rrustem Berisha. Epopeja e UÇK-së shënohet më 5, 6 dhe 7 mars, në ditët kur u vranë nga forcat serbe familjarë të Jasharëve në Prekaz.

DIALOGU ME SERBINË, NËN UDHËHEQJEN E MPJD-së

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës do ta udhëheqë dialogun për normalizim të raporteve me Serbinë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Kështu ka bërë me dije MPJD-ja pas një takimi të udhëheqësit të kësaj ministrie, Glauk Konjufca, me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialogun, Peter Sorensen, në Prishtinë. "Gjatë takimit Konjufca e informoi Sorensenin se procesi i dialogut tashmë do të jetë nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Në takim u diskutua momentum aktual në të cilin ndodhet dialogu si dhe u shkëmbyen pikëpamje mbi qasjen dhe parimet e nevojshme për të siguruar një proces më

efektiv dhe të qëndrueshëm", u tha në njoftim. Konjufca, i cili njëherësh është zëvendëskryeministri i parë, tha se Kosova mbetet "e përkushtuar që dialogun ta shohë si një mundësi për përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore me Serbinë, si dy shtete sovraane në rrugën e tyre drejt integritetit evropian". Megjithatë, mbetet e paqartë nëse Konjufca do të jetë bartës i këtij procesi, që ka nisur më 2011. Në mandatin e kaluar qeverisë, në nivel politik, Kosova në dialog është përfaqësuar nga kryeministri Albin Kurti, ndërkaq në nivel kryenegociatorësh nga Besnik Bisilimi. Vitet e fundit Kosova dhe Serbia kanë zhvilluar një sërë raundesh të dialogut në nivel kryenegociatorësh, por takime të nivelit të lartë politik nuk ka pasur që nga shtatori i vitit 2023.

Përgjatë vitesh të dialogut, Kosova dhe Serbia kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar në terren. Më 2023 palët arritën Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit, e njohur edhe si Marrëveshja e Ohrit, por BE-ja ka thënë se ajo ende nuk është zbatuar. Ndonëse marrëveshja nuk është nënshkruar, sipas bllokut evropian, ajo është e detyrueshme për të dyja palët. Kjo marrëveshje prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut 15-vjeçar.

Bislimi emërohet udhëheqës i Zyrës për Ekspertizë, Zbatim dhe Mbikëqyrje Strategjike

PRISHTINË, 23 SHKURT - Besnik Bislimi, dikur zëvendëskryeministër me përgjegjësi për integrim evropian dhe zhvillim ekonomik, si dhe udhëheqës i dialogut teknik me Serbinë, në qeverinë Kurti 3, ka marrë detyrë të re, atë të udhëheqësit të Zyrës për Ekspertizë, Zbatim dhe Mbikëqyrje Strategjike. Në vendim thuhet se mandati i tij në këtë pozitë do të zgjasë për aq kohë sa zgjatë mandati i kryeministrit, ndërsa Bislimi

obligohet ta deklarojë pasurinë sipas legjislacionit në fuqi. "Autorizohet z. Besnik Bislimi, të udhëheqë me Zyrën për Ekspertizë, Zbatim dhe Mbikëqyrje Strategjike. Mandati i të autorizuarit nga pika 1 e këtij vendimi, zgjatë për aq sa zgjatë mandati i kryeministrit. I autorizuari nga pika 1 e këtij Vendimi, obligohet të deklarojë pasurinë sipas legjislacionit në fuqi. Obligohen Zyra e Kryeministrit për zbatimin e



këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit", thuhet

në këtë vendim. Dokumenti, i nënshkruar nga Kurti më 20 shkurt 2026, detyron gjithashtu Zyrën e Kryeministrit të zbatojë këtë vendim, i cili hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit. Vendimi është dërguar edhe te vetë Bislimi, sekretari i përgjithshëm i ZKM-së dhe arkivi i qeverisë. Bislimi ka shërbyer si ministër i Financave dhe Transfereve gjatë qeverisë së parë të Albin Kurtit

në vitin 2020, ku mbikëqyri buxhetin, financat publike dhe politikat fiskale të vendit. Nga 2021 deri më tani Bislimi ka qenë zëvendëskryeministër i Kosovës, përgjegjës për integrimin evropian, zhvillimin ekonomik dhe koordinimin e dialogut me Serbinë. Ai ka udhëhequr gjithashtu projekte strategjike qeveritare dhe ka përfaqësuar Kosovën në takime ndërkombëtare për çështje ekonomike dhe politike.



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA TAKUAR TË HËNËN EDHE LIDERIN E LDK-së, LUMIR ABDIXHIKU, NË LIDHJE PËR ÇËSHTJEN E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT TË RI

ENDE PA PAJTIM PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT, RREZIK PËR ZGJEDHJE TË REJA NË KOSOVË?

Kanë mbetur vetëm edhe dhjetë ditë nga koha kur Kuvendi i Kosovës duhet ta zgjedhë presidenten apo presidentin e ri të vendit në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e reja të jashtëzakonshme parlamentare. Presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se dëshiron të kandidojë edhe për një mandat pesëvjeçar por, në këtë fazë, ende asnjë nga subjektet politike nuk kanë folur hapur nëse do ta mbështesin kandidaturën e saj. PDK-ja dhe LDK-ja kanë kërkuar konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar të hënën me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku. Pas dy orësh takim, për medie u deklarua Abdixhiku, i cili tha se u diskutua për dy rrugë për çështjen e presidentit apo presidentes. “Janë vetëm dy rrugë përpara: ose konsensus politik mes faktorëve të vendit, dhe ky konsensus duhet të ndërtohet në këto nëntë ditët e ardhshme: ose një marrëveshje klasike politike mes partive për çështjen e presidentit. Në të dyja rastet duhen 2/3 e votave. Mbeti të takohemi në ditët në vazhdim”, ka thënë ai, duke shtuar se pastaj, pas marrëveshjes politike, vijnë emrat e kandidatëve për president. Osmanit i skadon mandati më 4 prill dhe afati i fundit për

votimin e figurës që do ta ketë mandatin e ri është 4 marsi. Çështjen e presidentit Kurti e ka diskutuar të dielën edhe me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza. Kryeministria bëri me dije pas takimit se palët janë pajtuar që bashkëpunimi është i nevojshëm “duke qenë se duhen së paku 2/3 e deputetëve të Kuvendit për votim të suksesshëm”. “Kryeministri Kurti falënderoi kryetarin Hamza për bashkëpunimin në Kuvend me rastin e votimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Kryetari Hamza shprehu gatishmërinë për koordinim parlamentar për çështje të interesit shtetëror e kombëtar. U diskutua për zhvillimet politike në vend e më gjerë dhe nevojën për të hapur një kapitull të ri të komunikimit dhe dialogut konstruktiv qeveri-opozitë në të mirë të Republikës sonë dhe pluralizmit partiak e demokratik. Natyrisht, temë e bisedës ishte edhe çështja e

zgjedhjes së presidentit për çfarë kanë mbetur vetëm edhe 10 ditë kohë në bazë të afateve kushtetuese. U konstatua që bashkëpunimi është i nevojshëm, duke qenë se duhen së paku 2/3 e deputetëve të Kuvendit për votim të suksesshëm”, është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Ndërkaq lideri i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se zgjedhja e presidentit nuk është çështje vetëm e një partie, por e të gjithë neve si përfaqësues të zgjedhur të popullit. Në këtë drejtim ai ka thënë se për këtë arsye iu përgjigj pozitivisht ftesës së Kurtit për të diskutuar për zhvillimet politike dhe procesin e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit. “Si subjekt politik opozitar nuk kemi qenë dhe nuk jemi pengesë e proceseve shtetërore, por as nuk mbështesim kandidatura që nuk përfaqësojnë unitetin qytetar, sipas frymës kushtetuese. Uroj që të ketë reflektim nga ata që e

kanë përgjegjësinë kushtetuese për të propozuar kandidatura me mbështetje të gjerë, duke shmangur kalkulimet afatshkurtra partiake. Stabiliteti institucional është jetik dhe duhet të trajtohet si i tillë. Për ne, interesi shtetëror është mbi çdo kalkulim politik dhe këtë standard e mbrojmë me vendosmëri”, ka thënë Hamza pas takimit. Vjosa Osmani e ka bërë të qartë se synon edhe një mandat, por nuk dihet nëse i ka votat e nevojshme, pasi me raste ajo është përshkruar nga partitë opozitare si e afërt me partinë e Kurtit, Lëvizjen Vetëvendosje. Partitë e tjera nuk kanë përmendur deri më tani një kundërkandidat. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se do ta shqyrtonte këtë pozitë, nëse partitë e tjera opozitare do të kishin disponim mirëpo, sipas tij, ato kanë qenë të painteresuara. Për analistët politikë, rezultati i zgjedhjeve të dhjetorit ishte kryesisht pasojë e gabimeve strategjike të partive opozitare. Analisti Artan Muhaxhiri i tha DW-së se kjo patjetër që nuk do të thotë se partitë opozitare “duhet të dorëzohen pa kushte në procesin e zgjedhjes së

presidentit, sepse ky është kontekst i ri në të cilin ato janë të p a t e j k a l u e s h m e”. “Proporcionalisht me pushtetin parlamentar, roli parësor në gjetjen e zgjedhjes i takon gatishmërisë së Kurtit për të ofruar propozime të respektueshme dhe realiste, pa performanca komplikuese. Gjatë gjithë mandatit presidentja Osmani ka qenë përkrahëse e devotshme e ideve të kryeministrit Kurti, prandaj rikandidimi i saj eventual do të mund të mendohej vetëm nëse Kurti do të ishte i gatshëm për të lëshuar pe ndaj ndonjë kërkesë të rëndësishme opozitare”, thotë Muhaxhiri. Për secilën kandidaturë duhet të sigurohen të paktën 30 nënshkrime të deputetëve. Kurti i ka 57 ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa për zgjedhjen e presidentit duhen të paktën 80 vota prej 120 në total. Nëse në dy raundet e para të votimit një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t'i ketë 61 sosh. Pavarësisht prej rolit ceremonial presidencial, mospërmbushja e afateve i kushton shtetit. Nëse Kosova nuk e ka emrin e ri për pozitën e presidentit deri më 4 mars, atëherë duhet t'i organizojë zgjedhjet e reja parlamentare brenda 45 ditësh.

TË KUJDESESH DHE TË PAGUASH: BARRË E DYFISHTË PËR FAMILJARËT E PACIENTËVE NË QKUK

Në spitalin më të madh publik të Kosovës, familjarët janë bërë pjesë e domosdoshme e kujdesit për pacientët, duke kryer detyra bazë - nga ushqyerja deri te ndihma fizike. Pavarësisht këtij roli thelbësor, QKUK-ja ka vendosur që përcjellësit të paguajnë për të qëndruar pranë të afërmeve të tyre - një vendim që kritikët e shohin si transferim të përgjegjësiwe institucionale te familjet. Sistemi shëndetësor i Kosovës mbetet nën presion për shkak të burimeve të kufizuara dhe emigrimit të stafit mjekësor

Prishtinë, 23 shkurt - Në dhomat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) familjarët janë pjesë e përditshmërisë jo si vizitorë, por si kujdestarë. Në çdo shtrat, përveç pacientit, qëndron pranë edhe një bashkëshort, një fëmijë apo një prind, duke pritur në heshtje kalimin edhe të një dite tjetër. Në mungesë të kujdesit të mjaftueshëm institucional, ata janë bërë hallkë e padëklaruar e trajtimit: ushqejnë pacientët, ua sjellin ilaçet që mungojnë, i ndihmojnë të lëvizin dhe i mbikëqyrin madje edhe gjatë natës. Orë të tëra i kalojnë ulur në karrige dhe, kur kanë fat, mund të pushojnë për pak kohë në ndonjë shtrat të lirë. Për këtë rol, që shpesh është jetik, ata duhet të paguajnë. Vendimi i menaxhmentit të QKUK-së që obligon përcjellësit të paguajnë nga tri euro për natë, për të qëndruar pranë të afërmeve të tyre, ka shkaktuar pakënaqësi mes familjarëve, të cilët thonë se janë detyruar të marrin përsipër përgjegjësi që duhet t'i mbulojë vetë sistemi shëndetësor. Kosova ka një sistem shëndetësor publik të financuar kryesisht nga buxheti i shtetit, por me burime të kufizuara dhe pa një sistem funksional të sigurimeve shëndetësore universale.

Kujdestarë të detyruar nga rrethanat

Remzije Berisha ka më shumë se dhjetë ditë që nuk është ndarë nga bashkëshorti i saj në Klinikën e Neurokirurgjisë. “Jam këtu gjatë gjithë kohës dhe kujdesem për të”, thotë ajo për Radion Evropë e Lirë. “Mjekët kanë thënë se duhet të jetë gjithmonë dikush pranë tij. Derisa ta lirojnë, unë nuk largohem”, thotë Remzija, ndërsa qëndron e ulur në të njëjtin shtrat me bashkëshortin. Ajo tregon se netët i kalon aty, mes lodhjes dhe pasigurisë. “Rri dhe fle këtu si të mundem. Nuk dua t’ua vështirësoj punën mjekëve dhe infermierëve, por kur kemi nevojë, duhet t’i thërrasim. Ata kanë edhe shumë pacientë të tjerë”, thotë Remzija. Në të njëjtën dhomë, Durina Sylaj nga Deçani kalon ditët dhe netët në një karrige, duke u kujdesur njësoj për bashkëshortin. “Aq sa di dhe mundem, kujdesem për të”, thotë ajo, duke shtuar se nuk ka ankesa për përkushtimin e stafit,



por se vëren mungesën e infermierëve. Disa metra larg, në Klinikën e Neurologjisë, një tjetër familjar kujdeset për nënën e tij 80-vjeçare 24 orë në ditë. Në dhomën e saj ndodhet vetëm një shtrat dhe dy karrige të vjetra. “Mjekët kanë rekomanduar që të mos lihet vetëm asnjë moment. Ne e ushqejmë dhe kujdesemi që të mos i largojë tubat e oksigjenit”, thotë ai, por nuk do që të identifikohet. Në një dhomë tjetër, edhe Lindita kujdeset për bashkëshortin e saj i cili nuk mund të lëvizë. Ajo thotë se e ndihmon t’i kryejë edhe nevojat bazë. “Jam këtu prej disa ditësh. Vetëm një natë kam pasur fatin të fle pak në një shtrat të lirë. Përndryshe, gjithë kohën kam qëndruar në karrige. Burri ka nevojë për ndihmë të vazhdueshme. Atë që e bëjmë ne familjarët, nuk e bëjnë infermierët”, thotë ajo për Radion Evropë e Lirë.

Pagesë për një rol që nuk u takon

Pavarësisht prej këtij realiteti, familjarët që qëndrojnë pranë pacientëve duhet të paguajnë nga tri euro për natë. Të gjithë përcjellësit me të cilët bisedoi REL-i janë të indinjuar nga ky vendim, por i janë bindur atij për shkak të nevojës dhe mungesës së alternativave.

Si është gjendja në spitalet e vendeve të BE-së?

Në shumicën e spitaleve në Evropë, familjarët kanë të drejtë t'i vizitojnë pacientët gjatë orareve të caktuara, ndërsa qëndrimi jashtë këtyre orareve kërkon leje të veçantë nga stafi mjekësor. Shumë spitale kanë politika që lejojnë përfshirjen e familjarëve në kujdes, por kjo është kryesisht për mbështetje emocionale dhe komunikim, jo për zëvendësimin e stafit profesional. Sipas një publikimi të Revistës Evropiane për Shëndetin Publik, rreth 52 % e spitaleve evropiane kanë politika që lejojnë qasje të familjarëve edhe 24 orë nëse pacienti dëshiron.

Në QKUK thonë se kujdesi për pacientët ofrohet nga mjekët dhe infermierët në përputhje me kushtet dhe kapacitetet ekzistuese. Sipas një përgjigjeje me shkrim që ky institucion i dha Radios Evropë e Lirë, kjo tarifë ka nisur të zbatohet këtë muaj për të gjithë përcjellësit e pacientëve mbi 15 vjeç, në përputhje me udhëzimet administrative. “Ky obligim zbatohet në të gjitha klinikat, me përjashtim të Klinikës së Onkologjisë dhe klinikave ku trajtohen pacientë me sëmundje malinje, pavarësisht se pacientët mund të jenë të shtruar në klinika të tjera brenda QKUK-së”, thuhet në përgjigje. Por, përfaqësuesit e pacientëve e konsiderojnë këtë vendim të padrejtë dhe problematik. Besim Kodra nga Shoqata e Pacientëve të Kosovës thotë se vendimi reflekton dështimin institucional. “Institucionet, në vend se t’i përmbushin detyrimet e

veta, ua transferojnë përgjegjësinë familjarëve, të cilët nuk janë profesionistë shëndetësorë. Për më tepër, u kërkojnë edhe pagesë. Kjo është absurde”, thotë Kodra. Ai paralajmëron se prania e vazhdueshme e familjarëve në dhomat e spitalit, shpesh pa kushte të përshtatshme, mund ta rrisë rrezikun e infeksioneve brendasptalore si për pacientët ashtu edhe për vetë familjarët. Vitin e kaluar vetëm në Qendrën e Mjekimit Intensiv në QKUK infeksionet brendasptalore kanë prekur mbi 70 % të pacientëve gjatë disa muajve të vitit, ndërsa në Neonatologji, ku trajtohen foshnjat më të brishta, përqindja ka kaluar 20. Problemet e tjera që përcjellin vazhdimisht QKUK-në, përfshijnë edhe listat e gjata të pritjes së pacientëve, mungesën e barnave dhe kushtet e dobëta infrastrukturore - deri te mungesa e çarçafëve dhe sapunëve.

Sistemi nën presion

Të dhënat zyrtare tregojnë se në QKUK janë të punësuar rreth 2 000 infermierë. Megjithatë, sistemi shëndetësor përballet me një sfidë të vazhdueshme: largimin e profesionistëve shëndetësorë nga vendi. Të dhënat që siguroi Radio Evropë e Lirë nga Oda e Mjekëve të Kosovës tregojnë se nga viti 2018 deri në vitin 2021 janë lëshuar 493 certifikata për mjekë që planifikonin të punonin jashtë vendit. Ky trend ka vazhduar edhe në vitet pasuese. Ngjashëm ndodh edhe me infermierët - mesatarisht, rreth 300 infermierë largohen çdo vit nga Kosova, kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian, në kërkim të pagave më të larta dhe kushteve më të mira të punës. Ky fenomen është i pranishëm edhe në spitale rajonale të Kosovës. Ai ka reduktuar kapacitetet e sistemit dhe ka rritur barrën mbi stafin e mbetur, por, në mënyrë indirekte, edhe mbi familjarët e pacientëve. “... për shkak të mungesës së infermierëve, ne po detyrohemi të kujdesemi vetë për të afërmit tanë. Pagesa nuk mendoj se është në rregull”, thotë një përcjellës që prej ditësh kujdeset për babanë në repartin e Kirurgjisë Abdominale.

KOSOVA NË BORDIN E PAQES DHE ARKITEKTURA EUROATLANTIKE E SIGURISË: DIMENSIONI STRATEGJIK, JURIDIK DHE GJEOPOLITIK I MBËSHTETJES AMERIKANE PËR SOVRANITETIN E SHTETIT

Shkruan: Prof. dr.
Fejzulla BERISHA

Përfshirja e Republikës së Kosovës në Bordin e Paqes përbën një zhvillim me rëndësi të shumëfishtë - politike, juridike, diplomatike dhe strategjike. Ky akt nuk duhet parë si një element ceremonial apo simbolik i diplomacisë shumëpalëshe, por si pjesë integrale e procesit të konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës në kuadër të arkitekturës euroatlantike të sigurisë.

Në themel të kësaj arkitekture qëndron doktrina e sigurisë kolektive dhe mbrojtjes së rendit demokratik ndërkombëtar, e mishëruar institucionalisht në North Atlantic Treaty Organization. Parimet mbi të cilat ndërtohet Aleanca - sovraniteti shtetëror, integriteti territorial, parandalimi i agresionit, solidariteti ndërmjet shteteve demokratike dhe mbrojtja e rendit kushtetues - janë pikërisht ato parime mbi të cilat është ndërtuar edhe shtetësia e Kosovës.

I. Dimensi i historik: Nga ndërhyrja humanitare te konsolidimi shtetëror

Rasti i Kosovës është një precedent i veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare moderne. Ndërhyrja e vitit 1999, e udhëhequr nga aleanca euroatlantike, ishte përgjigje ndaj një krize humanitare me përmasa të gjenocidit dhe spastrimit etnik. Kjo ndërhyrje nuk ishte thjesht operacion ushtarak; ajo ishte afirmim i parimit se siguria njerëzore dhe mbrojtja e të drejtave themelore janë pjesë e pandashme e rendit ndërkombëtar.



Pas përfundimit të konfliktit, Kosova hyri në një proces të mbikëqyrur ndërkombëtar të ndërtimit institucional, duke kulmuar me shpalljen e pavarësisë dhe me njohjen nga një numër i konsiderueshëm shtetesh demokratike. Në këtë proces, roli i Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte dhe mbetet themelor.

II. Mbështetja amerikane si garanci e sovranitetit dhe integritetit territorial

Mbështetja amerikane për Kosovën nuk ka qenë e rastësishme, as episodike. Ajo ka qenë konsistente, strategjike dhe e bazuar në një vizion afatgjatë për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Në planin diplomatik, ShBA ka mbrojtur vazhdimisht të drejtën e Kosovës për sovranitet dhe integritet territorial në forume ndërkombëtare. Në planin e sigurisë, prania dhe bashkëpunimi ushtarak kanë qenë faktor parandalues ndaj çdo tentative destabilizuese. Ky angazhim përbën një formë të "garancisë strategjike" - një koncept

i njohur në doktrinën e marrëdhënieve ndërkombëtare - ku mbështetja e një fuqie të madhe kontribuon në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe të legjitimitetit ndërkombëtar të një shteti të ri. Në këtë kuptim, sovraniteti i Kosovës nuk është vetëm deklarativ; ai është i mbështetur nga një arkitekturë reale sigurie dhe nga partneriteti me fuqinë kryesore të rendit liberal ndërkombëtar.

III. Përfshirja në Bordin e Paqes: afirmim i subjektivitetit ndërkombëtar

Përfshirja e Kosovës në Bordin e Paqes ka disa dimensione: Dimensi i juridik - Kosova afirmohet si subjekt aktiv i së drejtës ndërkombëtare, jo vetëm si përfituese e sigurisë, por si kontribuuese në ndërtimin e saj. Dimensi i diplomatik - Pjesëmarrja në forume të tilla e rrit kapitalin diplomatik dhe e vendos Kosovën në rrjetet vendimmarrëse ndërkombëtare. Dimensi i strategjik - Kosova pozicionohet si faktor stabiliteti dhe si partnere e besueshme në kuadër

të rendit euroatlantik. Në kontekstin e sfidave aktuale globale - luftërave hibride, dezinformimit, kërcënimeve ndaj rendit demokratik - përfshirja e Kosovës në mekanizma të paqes është kontribut konkret në forcimin e kohezionit euroatlantik.

IV. Kosova si faktor stabiliteti në Ballkanin Perëndimor

Pavarësisht sfidave të vazhdueshme, Kosova ka dëshmuar përkushtim ndaj dialogut, bashkëpunimit rajonal dhe reformave demokratike. Transformimi gradual i sektorit të sigurisë, profesionalizimi i institucioneve dhe koordinimi me partnerët ndërkombëtarë janë dëshmi të qarta të orientimit euroatlantik.

Kosova nuk përfaqëson rrezik për askënd; ajo përfaqëson modelin e një shteti të dalë nga konflikti që ndërton institucione demokratike dhe kontribuon në stabilitet rajonal. Përfshirja në Bordin e Paqes e fuqizon këtë rol.

V. Dimensi i normativ: Forca euroatlantike si sistem vlerash

Forca euroatlantike nuk është vetëm forcë ushtarake; ajo është sistem vlerash. Demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe solidariteti ndërmjet shteteve demokratike janë themeli i kësaj force. Në këtë kuptim, përfshirja e Kosovës në mekanizma të paqes është konfirmim se vendi është pjesë e

këtij sistemi vlerash. Mbështetja amerikane dhe euroatlantike për Kosovën nuk është kundër askujt; ajo është në mbrojtje të parimeve universale të rendit ndërkombëtar.

VI. Perspektiva e së ardhmes: Integrimi i plotë euroatlantik

Objektivi strategjik i Kosovës mbetet integrimi i plotë në strukturat euroatlantike. Përfshirja në Bordin e Paqes është hap në këtë drejtim. Ajo rrit kredibilitetin ndërkombëtar dhe forcon argumentin se Kosova është e gatshme të marrë përgjegjësi në ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Në një kohë të polarizimeve globale, pozicionimi i qartë i Kosovës në kampin euroatlantik është jo vetëm zgjedhje politike, por domosdoshmëri strategjike. Përfshirja e Republikës së Kosovës në Bordin e Paqes dhe mbështetja e palëkundur e Shtetet e Bashkuara të Amerikës për sovranitetin dhe integritetin territorial të saj përfaqësojnë dy shtylla të konsolidimit të shtetësisë dhe të sigurisë kombëtare.

Kosova sot nuk është thjesht objekt i politikave ndërkombëtare; ajo është subjekt aktiv i tyre. E vendosur në arkitekturën e North Atlantic Treaty Organization, ajo afirmon përkatësinë e saj të pakthyeshme në familjen euroatlantike dhe kontributin e saj në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe rendit demokratik ndërkombëtar. Ky realitet duhet artikuluar qartë: sovraniteti i Kosovës është i mbrojtur, integriteti territorial është i garantuar dhe orientimi euroatlantik është strategji e pakthyeshme kombëtare.

KOSOVË - SHQIPËRI - MAQEDONI E VERIUT: THEKSOHET ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË PËRPARIMIN E AGJENDËS SË INTEGRIMIT EVROPIAN

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 23 SHKURT - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), në bashkëpunim me CSDG - Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Center for Investigative Journalism SCOOP-Macedonia, ka mbajtur në Tiranë një takim rajonal me përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë dhe institucione publike nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, ku u diskutuan përvojat dhe sfidat në avancimin e vendeve tona drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Gjatë këtij takimi u diskutua për Grupin e Parë të Kapitujve Negociues të BE-së (Grupkapitulli



1), i cili përfshin: Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore; Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria; Kapitulli 5 - Prokurimi Publik; Kapitulli 18 - Statistikat; Kapitulli 32 - Kontrolli

Financiar. Në diskutim u trajtuan përvojat e Shqipërisë në përmbushjen e obligimeve që lidhen me Grupkapitullin 1, praktikën e mira dhe mësimet që mund të

shërbejnë për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. U diskutuan gjithashtu sfidat e përbashkëta rajonale, boshllëqet ekzistuese dhe mundësitë për bashkëpunim dhe mësim të ndërsjellë. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e angazhimit shumëpalësh dhe dialogut të bazuar në fakte, si dhe rolin kyç të shoqërisë civile në shtyrjen përpara të agjendës së integrimit evropian.

U nënvizua se progresi në këtë grupkapitull kërkon punë të qëndrueshme teknike dhe vullnet politik, si dhe krijimin e një mjedisi favorizues për pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile. Takimi u organizua në kuadër të

projektit "Vlerësim Rajonal i Reformave Thelbësore: Avancimi i Bashkëpunimit për Grupkapitullin 1 të BE-së në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut" (Regional Fundamentals Snapshot: Advancing Cooperation on EU Cluster 1 in Albania, Kosovo, and North Macedonia). Projekti mbështetet nga Fondi i Ballkanit Perëndimor dhe synon ndërtimin e një qasjeje më të koordinuar rajonale për avancimin e reformave në kuadër të Grupkapitullit 1. Kjo punëtori u mbajt gjithashtu në kuadër të Muajit të Angazhimit të Shoqërisë Civile për Anëtarësimin në BE, i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri.

Edhe në rigjykim Dushko Arsiq dënohet me 13 vjet burgim për krime lufte

PRISHTINË, 23 SHKURT - Edhe në procesin e rigjykimit, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka

dënuar me 13 vjet burgim Dushko Arsiq, i akuzuar për krime lufte kundër popullatës

civile. Trupi gjyqësor tha se atij do t'i llogaritet koha që ka qëndruar në paraburgim, raporton

"Betimi për Drejtësi". Edhe në procesin e parë gjyqësor, Arsiq më 2 shkurt të vitit 2024 u gjet

fajtor dhe u dënua po me 13 vjet burgim, por Apeli e ktheu më pas rastin në rigjykim.

ÇFARË TREGOJNË VËREJTJET E FMN-së NGA MISIONI DYJAVOR MBIKËQYRËS NË KOSOVË?

Shkruan: Avdullah HOTI

Më 13 shkurt 2026 misioni i FMN-së nga Uashingtoni e përmbylli vizitën dyjavore mbikëqyrëse në Kosovë në kuadër të konsultimeve sipas Nenit IV të Marrëveshjes së FMN-së. Sipas këtij neni, FMN-ja ka mandat të mbikëqyrë politikat ekonomike dhe financiare të vendeve anëtare për të siguruar stabilitetin monetar global. Që nga anëtarësimi i Kosovës në FMN më 2009, që ishte arritje historike për shtetin e ri të Kosovës, FMN-ja ka kryer disa misione të tilla në Kosovë.

Në fund të kësaj vizite, misioni e lëshoi një deklaratë të gjatë ku theksohen disa çështje që paraqesin rrezik për stabilitetin ekonomik dhe fiskal të Kosovës.

Sigurisht se misionet e FMN-së zakonisht janë konservatore në qëndrimet e tyre, por çështjet e ngritura kësaj radhe koïncidojnë me vërejtjet që i kam ngritur në katër vitet e fundit sa i përket politikave ekonomike dhe fiskale të Qeverisë së Kosovës.

Në vijim po i theksoj disa nga vërejtjet e FMN-së, siç paraqiten në deklaratë:

1. Rritja ekonomike: ka rënë në 3.25 për qind në fund të çerekut të tretë të vitit 2025, nga 4.75 për qind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo ka ardhur si rezultat i dobësimit të konsumit dhe investimeve private për shkak të ngadalësimit të aktivitetit kreditor dhe të të ardhurave reale. Rritja ekonomike sivjet pritet të shkojë në 3.8 për qind dhe eventualisht të konvergojë me normën e rritjes potenciale prej 4 për qind.

2. Inflacioni: në dhjetor 2025 u rrit në 5.25 për qind, krahasuar me një vit më parë kur ishte vetëm 1.1 për qind. Kjo rritje erdhi për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve.

3. Bilanci tregtar: është përkeqësuar për shkak të rritjes së importeve, sidomos të importit të energjisë. Si rezultat, është zgjeruar deficit i llogarisë rrjedhëse me jashtë në 9.6 për qind të vlerës së Produktit të

Brendshëm Bruto, nga 8.4 për qind sa ishte në 2024.

4. Pagat në sektorin publik: duhet të ndërlidhen me normën e inflacionit.

5. Paga minimale: duhet të përcaktohet duke balancuar produktivitetin e punës dhe koston e jetës.

6. Shpenzimet në mallra dhe shërbime: duhet të identifikohen mundësitë për kursime.

7. Kreditë bankare: kanë arritur nivelin prej 60 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto, që është ndër më të lartat në vendet evropiane me ekonomi në zhvillim, të cilat duhet të mbikëqyren në veçanti sa i përket ekspozimit të bankave ndaj sektorit të patundshmërive.

8. Institucionet mikrofinanciare: duhet të ndërmerren masa për të mbikëqyruar këto lloj institucionesh financiare jobankare, në mënyrë që të ruhet integriteti i sistemit financiar, të mbrohen klientët, si dhe të zbatohen praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim. Sigurisht se në deklaratën e FMN-së ka edhe çështje të tjera për zhvillime pozitive që kanë ndodhur. Por, marrë si tërësi, vërejtjet e renditura më sipër nxjerrin në pah mungesën e menaxhimit të duhur

makroekonomik dhe fiskal të ekonomisë së Kosovës në vitet e fundit. Ja disa nga argumentet që dëshmojnë këtë:

- Mungesa e investimeve publike për vite me radhë, duke i lënë përgjysmë tash e pesë vite të gjitha arteriet kryesore të infrastrukturës rrugore, e ka kufizuar rritjen ekonomike. Kjo ka nënkuptuar se qindra miliona euro i kanë munguar ekonomisë për shkak të mosrealizimit të projekteve kapitale, duke shkaktuar pasoja multiplikuese negative në gjithë zinxhirin ekonomik. Për më tepër, hapësira fiskale në kuadër të buxheteve vjetore për projekte të reja ka mbetur pothuajse zero, pasi projektet ekzistuese të papërfunduara është dashur të përfshihen në buxhet vit pas viti. Kjo e ka pamundësuar lirimin e hapësirës në buxhet për projekte të tjera.

- Është harruar plotësisht infrastruktura hekurudhore, që është vitale për të ulur kostot e transportit dhe për të mbrojtur rrugët dhe autostradat nga dëmtimi. Jo vetëm që nuk janë ndërtuar linja të reja hekurudhore, por edhe linjat ekzistuese nuk janë mirëmbajtur dhe funksionalizuar. Njëra nga këto linja, ajo që lidh Klinën me Prizrenin, pothuajse ka dalë nga

funksioni për shkak të disa intervenimeve të vogla që kanë munguar tash e sa vite.

- Mungesa e plotë e politikave fiskale, në veçanti e politikave industriale, ka bërë që prodhimi vendor të ngecë. Si rezultat, rritja e konsumit privat dhe publik me kalimin e viteve është mbuluar pothuajse plotësisht nga importi, i cili është dyfishuar në katër vitet e fundit, duke arritur në 7 miliardë euro. Struktura e importit nxjerr më së miri në pah mungesën e prodhimit vendor të mallrave elementare. Prodhimi i disa prej këtyre mallrave elementare, për të cilat importi po rritet, subvencionohet nga buxheti i shtetit.

- Mungesa e përshtatjes së pagave, pensione dhe skemave sociale me normën e inflacionit e ka zvogëluar jashtëzakonisht shumë fuqinë blerëse të të ardhurave. Shtesat e njëhershme të pensione dhe skemave të tjera nuk e kanë zgjidhur problemin e rënies së fuqisë blerëse të të ardhurave të familjeve nga inflacioni. Këto lloj shtesash duken qartësisht se kanë pasur motive elektorale.

- Menaxhimi i keq i shpenzimeve publike ka bërë që në vazhdimësi të vonohen subvencionet për bujqit, të cilët detyrohen të marrin

kredi për inputet bujqësore.

- Cili është roli i institucioneve mikrofinanciare? Pse lejohen këto institucione të japin kredi për familje me interes prej 21.7 për qind dhe për bujq me 16.3 për qind (sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës)?

- Përse sektori financiar në Kosovë mbetet tejet i pazhvilluar, duke qenë i fokusuar vetëm në kredidhënie? Përse sektori i sigurimeve ka mbetur i fokusuar vetëm në sigurimet e detyrueshme?

Unë nuk pres që të ketë reflektim në këto çështje as nga qeveria e re. Politikat ekonomike, në veçanti politikat fiskale dhe industriale, kërkojnë ekspertizë. Në këtë qeveri, sikurse edhe në atë paraprake, ekspertiza është qartësisht në deficit të madh. Mbi të gjitha, politikat fiskale dhe industriale që zhvillojnë sektorin privat dhe rrisin punësimin privat zhvillohen nga ata që kanë orientime zhvillimore të ekonomisë së tregut.

Në vend që qeveria e re të fokusohet në këto çështje që i ka ngritur FMN-ja, puna e parë që po bëjnë është përgatitja e ligjit për vendosjen e çmimeve tavan në produkte të caktuara.

Kjo nuk është zgjidhja për problemin e inflacionit dhe rënien e fuqisë blerëse të të ardhurave të familjeve. Historia ka treguar shumë qartë se, përveç për produktet dhe shërbimet që ofrohen në tregje të monopolizuara, siç është energjia, uji, transporti hekurudhor e të ngjashme, rritja e çmimeve të mallrave të tjera nuk mund të kufizohet me ligje.

Çmimet mund të mbahen të moderuara duke ulur kostot e prodhimit, kostot e transportit dhe tatimet mbi ato produkte.

Mbi të gjitha, çmimet mund të mbahen të moderuara duke zbatuar politika industriale që mbështesin prodhuesit vendorë në prodhimin e atyre produkteve. Asnjëra nga këto masa nuk është ndërmarrë në pesë vitet e fundit; si rezultat, importi dhe inflacioni janë rritur në vazhdimësi.

Qeveria dhe UNDP-ja rikonfirmojnë vazhdimin e bashkëpunimit

PRISHINË, 23 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim përfaqësuesin e përhershëm të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Nuno Queiros. Në këtë takim të parë prej formimit të qeverisë së re, Queiros e uroi kryeministrin Kurti për mandatin e tij dhe të kabinetit qeveritar. Kryeministri e falënderoi Queirosin për urimet dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe profesional ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNDP-së, duke theksuar se UNDP mbetet partner i besueshëm dhe strategjik në

forcimin e institucioneve dhe në zbatimin e reformave me rezultate konkrete për qytetarët.

Në takim u rikonfirmua gatishmëria për vazhdim të bashkëpunimit në fusha prioritare si lufta kundër korrupsionit dhe sundimi i ligjit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, dokumentimi dhe adresimi i krimeve të luftës, mbrojtja e mjedisit dhe tranzicioni i gjelbër, si dhe reforma në arsim dhe ngritja e kapaciteteve institucionale.

Kryeministri theksoi se reforma në prokurimin publik mbetet një nga prioritetet kryesore të qeverisë, me fokus në rritjen e transparencës,

digjitalizimin e proceseve dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës kundër keqpërdorimit të fondeve publike. Në këtë drejtim do të vazhdojmë me miratimin e strategjisë anti korrupsion dhe Ligjin për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Të dyja palët u pajtuan se bashkëpunimi i deritanishëm ka dhënë rezultate të prekshme dhe shprehën përkushtimin për ta thelluar më tej partneritetin në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe forcimit të institucioneve të Republikës së Kosovës.



ODA EKONOMIKE BRITANIKE: MASAT URGJENTE, TË NEVOJSHME NË SEKTORIN E MINIERAVE NË KOSOVË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHKURT - Oda Ekonomike Britanike në Kosovë ka vlerësuar se duhen masa urgjente të nevojshme në sektorin e minierave në Kosovë. Kjo odë ka theksuar se mbështetja e Mbretërisë së Bashkuar pas konfliktit në Kosovë është fokusuar në ndërtimin e institucioneve të forta të sundimit të ligjit, autoriteteve efektive të të hyrave dhe organeve të pavarura rregullatore. “Ndër arritjet më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi janë Dogana e Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) të cilat konsiderohen ndër historitë më të suksesshme të zhvillimit institucional në Kosovë. Të dyja institucionet përfaqësojnë shembuj të qëndrueshëm të ndërtimit të shtetit përmes ekspertizës teknike dhe mbështetjes afatgjatë të Mbretërisë së Bashkuar dhe njihen si ndër institucionet kryesore në rajon”, thuhet në

komunikatën e Odës Ekonomike Britanike në Kosovë, duke shtuar se që nga viti 2020 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) ka hasur në vështirësi të vazhdueshme operationale sa me Bord të Drejtorëve, po aq edhe pa të, duke qenë shpesh jofunksionale, gjë që ka krijuar sfida serioze për industrinë minerare dhe ka penguar funksionimin normal të sektorit minerar dhe të gjitha kompanive të përfshira në këtë sektor. “Fatkeqësisht, gjatë kësaj periudhe është dëmtuar reputacioni i KPM-së si një nga institucionet më kredibile në vend, gjë që ka ndikuar negativisht edhe në interesimin e kompanive ndërkombëtare për investime në Kosovë. Bordi i KPM-së në përbërjen e fundit, i emëruar në maj 2024, ka lëshuar vetëm 60 licenca nga 316 aplikime të dorëzuara, që do të thotë se më pak se 20% të aplikacioneve janë trajtuar, dhe të gjitha licencat e miratuara kanë qenë për resurse jo-metallore, duke përjashtuar aplikimet e lidhura me Trepçën.

Për më tepër, koha e pritjes për vendime ka arritur deri në 50 muaj, pavarësisht afatit ligjor të paraparë prej tre muaj, me mundësi shtesë prej dy muaj në raste të veçanta kur kërkohen informacione shtesë, maksimumi pesë muaj gjithsejtë”, ka vlerësuar Oda Ekonomike Britanike. Ajo ka potencuar se për krahasim, në vitin 2020 KPM-jë menaxhonte 854 licenca. Sipas kësaj ode, vetëm në periudhën janar - gusht 2020 (për shtatë muaj) janë lëshuar 167 licenca. “Në dallim, gjatë mandatit të fundit dyvjeçar janë lëshuar vetëm 60 licenca, me rreth 160 licenca aktualisht nën menaxhim. Këto të dhëna janë marrë nga faqja zyrtare e KPM-së. Për më tepër, KPM nuk ka raportuar në Komisionin Parlamentar për Ekonomi që nga viti 2020! Gjithashtu është evidentuar një trajtim jo i barabartë i kompanive private kundrejt atyre shtetërore si Trepça apo KEK-u. Duhet theksuar se Ligji duhet t’i trajtoj njëjtë të gjitha palët pavarësisht pronësisë së tyre. Pos kësaj,

mungesa e licencimit për gurthyesit si dhe komplikimet që kanë rrjedh nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pronë Publike ka çuar në situata ku Kosova është detyruar të importojë në mënyrë enorme rërë dhe zhavorr nga shtet fqinjë. Ky proces ka rezultuar edhe me rritjen e çmimeve për rërë, zhavorr, beton dhe materiale të tjera të ngjashme”, është thënë në këtë komunikatë. Oda Ekonomike Britanike ka theksuar se Kosova dikur njihej për legjislacionin më të avancuar minerar në Evropë, të bazuar në praktikat më të mira të Australisë, duke përfshirë parimin “i pari që aplikon, i pari që shërbehet”, i ashtuquajtur “e drejta e të parit”. “Megjithatë, moszbatimi i sundimit të ligjit, veçanërisht kur institucionet nuk respektojnë ligjet e tyre, si periudha e shqyrtimit 3+2 muaj, ka çuar në rënie të kredibilitetit institucional. Si pasojë, interesi i investitorëve zvogëlohet, pasi kompanitë zgjedhin vende të tjera për eksplorim. Edhe pse Kosova mbetet territor shumë atraktiv për eksplorime

minerare, rrezikon të mbetet pa investitorë ndërkombëtarë dhe pa zhvillim serioz në sektorin e hulumtimeve minerale. Kjo nuk është mënyra se si mund të tërhiqen investitorët e huaj, veçanërisht duke pasur parasysh se statistikisht tregojnë se vetëm 0.01% e projekteve të hulumtimeve përfundojnë si miniera operative, zakonisht pas 15 deri 30 vitesh të punës intensive. Kjo dëshmon se investitorët seriozë kërkojnë stabilitet afatgjatë juridik dhe institucional”, thuhet tutje. Në këtë rast, Oda Ekonomike Britanike në Kosovë kërkon: Trajtimin e përsheptuar të të gjitha aplikacioneve të mbetura; Zbatim të plotë të ligjit, duke siguruar që KPM të përgjigjet brenda afatit ligjor prej tre muajsh, dhe jo më vonë se pesë muaj në raste specifike; Hartimin dhe miratimin e një Strategjie të re Minerare të Kosovës, pasi ajo e mëparshme ka skaduar në vitin 2025; dhe plotësimin urgjent të Bordit të KPM-së për të rikthyer funksionalitetin dhe kapacitetin e plotë operacional.

AKB: 22 % INTERES PËR FAMILJET, 16 % PËR BUJQIT, A ËSHTË KJO MBËSHTETJE APO FAJDE E HAPUR FINANCIARE?



PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka reaguar me shqetësim ndaj normave jashtëzakonisht të larta të interesit që aplikojnë institucionet mikrofinanciare në Kosovë. AKB-ja ka theksuar se sipas raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, kreditë për familjet arrijnë deri rreth 22 % interes, ndërsa për bujqit mbi 16 %. “Kjo nuk është më ndihmë financiare. Kjo është një barrë e

rëndë që po i shtyp dhe varfëron edhe më shumë familjet dhe fermerët e Kosovës. Institucionet mikrofinanciare janë krijuar për të ndihmuar shtresat më të ndjeshme të shoqërisë - familjet me të ardhura të ulëta, bizneset e vogla dhe bujqit. Por realiteti sot po tregon diçka krejt tjetër. A po e luftojnë varfërinë apo po përfitojnë nga varfëria e qytetarëve? Kur një familje merr kredi me interes rreth 22 %, ky nuk është zhvillim ekonomik -

është një rrugë drejt borxhit të pafund dhe rrezikut për falimentim familjar. Kur një bujk detyrohet të financohet me mbi 16 %, kjo nuk është mbështetje për bujqësinë - është goditje direkte për prodhimin vendor dhe për sigurinë ushqimore të vendit”, ka thënë Shahini. AKB-ja vlerëson se këto norma interesi janë të pajustificueshme dhe socialisht të rrezikshme, dhe në praktikë afrohen me një formë fajdeje të legalizuar me kontrata zyrtare, që po godet

pikërisht ata që kanë më pak mundësi dhe më shumë nevojë për mbështetje. “Prandaj, Aleanca Kosovare e Bizneseve kërkon hetim të menjëhershëm institucional për praktikën e interesit në sektorin mikrofinanciar. 1. Vendosijen e një tavani ligjor për normat e interesit, veçanërisht për familjet dhe bujqit. 2. Ndërhyrje të shtetit për mbrojtjen e qytetarëve nga kreditë me kosto të papërbalueshme. 3. Transparencë të plotë mbi

fitimet dhe praktikën financiare të institucioneve mikrofinanciare. Nëse kjo situatë vazhdon, ekziston rreziku real që sistemi financiar të shndërrohet nga një instrument zhvillimi në një mekanizëm që thellon varfërinë dhe pabarazinë sociale në Kosovë. Kosova nuk ka nevojë për kredi që i fundos qytetarët. Kosova ka nevojë për financim të drejtë që i zhvillon familjet, bujqit dhe ekonominë e vendit”, ka thënë Shahini.

RRITET INDEKSI I PËRGJITHSHËM I ÇMIMEVE TË INPUTEVE NË BUJQËSI



PRISHTINË, 23 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi për vitet 2020-2025. Ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinarë, në

kompani, tregje dhe vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Në vitin 2025 indeksi vjetor i çmimeve të inputeve në bujqësi ka rritje për 1,1 % për Input 1 krahasuar me vitin 2024. Ndërkaq, indeksi i çmimeve për Input 2 ka rritje për 2,4 %. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) në vitin 2025

ka rritje për 1,7 % krahasuar me vitin 2024. Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve në bujqësi ka rritje për 28,5 % për Input 1 dhe 59,5 % për Input 2 në vitin 2025 krahasuar me vitin 2020. Indeksi vjetor i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rritje për 42 % në vitin 2025 krahasuar me vitin 2020.

Produktet që përbëjnë bazën për Indeksin e çmimit të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet

grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues dhe energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime të tjera.



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

"EuroBasket 2029", Kosova nis përgatitjet për ndeshjen kundër Sllovakisë

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kombëtarja e Kosovës në basketboll të hënën ka nisur grumbullimin para ndeshjes me Sllovakinë, për të cilën tashmë selektori Bujar Loci ka publikuar listën e

zgjeruar. "Dardanët" grumbullimin do ta mbajnë në Prizren, ku edhe do të zhvillohet ndeshja me Sllovakinë, ndërsa do të stërviten nga dy herë në ditë. Dueli që luhet të premten

nga ora 19:00 në palestrën "Sezai Surroi" i takon xhiros së dytë të parakualifikimeve për "EuroBasket 2029", ku si Kosova ashtu edhe Sllovakia kanë nga një fitore. Kosova në këtë përballje do të jetë pa

Dardan Berishën e Drilon Hajrizin, ndërsa është ftuar amerikan i natyralizuar Divine Myles. FBK-ja ka bërë me dije se biletat e ndeshjes kanë dalë në shitje dhe çmimi i biletës është 5 euro.



DRITA SHFRYTËZON HUMBJET E BALLKANIT DHE PRISHTINËS, MERR KREU NË TABELË

PRISHTINË, 23 SHKURT - Xhiro 21 në Superligën e Kosovës në futboll ka sjellë ndryshime në garën për titull. Ballkani dhe Prishtina kanë pësuar humbje ndaj Ferizaj, përkatësisht Gjilanit, duke humbur terren në renditje. Në anën tjetër, Drita ka shfrytëzuar më së miri situatën, duke mposhtur Llapi dhe duke marrë kreun e tabelës me 38 pikë. Rezultatet e fundit e bëjnë edhe më interesante garën për titull, pasi Ballkani

dhe Prishtina mbeten në ndjekje të lideres, Dritës. Sezoni pritët të vazhdojë me rivalitet të fortë deri në xhirot e fundit. Edhe gara për mbijetesë është bërë interesante. Të hënën Prishtina e Re ka mposhtur Drenicën. Për Prishtinën e Re kjo është fitorja e dytë radhazi në Superligë, e cila është ngritur në pozitën e parafundit në tabelë me 21 pikë, sa i ka edhe Drenica, por që ka rënë në vendin e fundit.



RENDITJA TABELARE:

Drita	38
Ballkani	36
Prishtina	36
Malisheva	34
Dukagjini	31
Gjilani	30
Llapi	22
Ferizaj	22
Prishtina e Re	21
Drenica	21

PSG-JA VENDOS TË MOS APELOJË, MBAPPE DO T'I MARRË 61 MILIONË EURO

PARIS, 23 SHKURT - Gjatë 12 muajve të fundit Kylian Mbappe ka qenë i përfshirë në një betejë ligjore me ish-klubin e tij, Paris Saint-Germain. 27-vjeçari ka pretenduar se i detyrohen bonuse të papaguara, dhe në dhjetor, Gjykata Preud'homme vendosi në favor të sulmuesit të Real Madridit. Mbappe do të kompensohej me 61 milionë euro dëmshpërblim, megjithatë PSG kishte rezervuar të drejtën për ta apeluar vendimin. Sidoqoftë, ata kanë zgjedhur të mos e bëjnë këtë, sipas raportimeve të "Marca"-s. Si pasojë, ai së shpejti do të paguhet, me klubin e Ligës 1 që konfirmon: "Për hir të përgjegjësisë dhe



për të dhënë një fund përfundimtar një procedure që ka zgjatur shumë gjatë, klubi ka vendosur të mos e zgjatë këtë proces ligjor." Shuma që do t'i paguhet Mbappes është saktësisht 60.9 milionë euro. Përbërja e kësaj shume është si më poshtë: 36.6 milionë euro për bonusin e fundit të nënshkrimit; 17.25 milionë euro për pagat e muajve prill, maj dhe qershor 2024; 1.725 milionë euro për pagesën e pushimeve; 1.5 milion euro bonus etik për muajt prill, maj dhe qershor 2024; dhe përfundimisht 150 mijë euro bruto për pushimet e paguara mbi kujtimin e bonusit etik për të njëjtët muaj. Tani Mbappe mund të presë

me kënaqësi paratë që i takojnë, por më e rëndësishmja ai mund ta lërë këtë çështje pas vetes. Është një proces në të cilin ka qenë i përfshirë për një kohë, por fakti që ka përfunduar do të thotë se ai nuk ka më nevojë të merret me PSG-në. Sa i përket fushës, Mbappe shpreson të rikthehet në formën e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Ai pati një paraqitje të dobët në humbjen e fundjavës ndaj CA Osasuna, por do ta ketë mundësinë të rikuperojë kur Real Madridi ta presë Benfican në ndeshjen e dytë të raundit "play-off" të Ligës së Kampionëve në Santiago Bernabeu Stadium të mërkurën në mbrëmje.

Peja largon tre basketbollistë të huaj

PEJË, 23 SHKURT - Amerikanët Alan Herndon, Dequan Morris dhe Tajh Green nuk janë më basketbollistë të skuadrës së Pejës. Te tre basketbollistët e huaj kanë shkëputur kontratën me Pejën me marrëveshje të dyanshme, kanë bërë me dije nga klubi që garon në

Superligën e Kosovës. Herndon, Morris e Green ishin lojtarët e huaj që iu bashkuan Pejës në fillim të sezonit dhe klubi ka paralajmëruar ardhje të reja pas largimit të tyre. Për dallim prej Green e Herndon, Morris ka regjistruar vetëm 4 paraqitje për Pejën në

Superligën e Kosovës, duke realizuar në total 13 pikë. Green ka luajtur me një mesatare prej 14 pikëve e 8 kërcimeve për ndeshje, ndërsa Herndon ka regjistruar 8 pikë e 7 kërcime për ndeshje te Peja, ekip që ka 10 humbje karshi 11 fitoreve deri më tani në Superligë.





ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: ☐ Furnizim ☒ Shërbime ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 01-26

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdushëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: Kontratë për Shërbimet e Mirëmbajtjes për Platformën e Odës së Mjekëve të Kosovës

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

- ☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).
- ☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: https://omk-rks.org/

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: 06/03/2026 ora 14:00.
Afati i fundit për aplikim në Tender është: 10/03/2026 ora 12:00.
Hapja e ofertave bëhet me datën: 10/03/2026 ora 12:00.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: ☐ Furnizim ☒ Shërbime ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 01-26

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdushëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: Kontratë për shërbime të avokatisë përfaqësim dhe këshillim ligjor për OMK-në

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

- ☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).
- ☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: https://omk-rks.org/

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: 03/03/2026 ora 14:00.
Afati i fundit për aplikim në Tender është: 05/03/2026 ora 12:00.
Hapja e ofertave bëhet me datën: 05/03/2026 ora 12:00.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: ☐ Furnizim ☒ Shërbime ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 02-26

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdushëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: Kontratë për shërbime të transportit ajror

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

- ☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).
- ☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: https://omk-rks.org/

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: 06/03/2026 ora 14:00.
Afati i fundit për aplikim në Tender është: 10/03/2026 ora 12:00.
Hapja e ofertave bëhet me datën: 10/03/2026 ora 12:00.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Tropicana Club” SH.P.K. pronar Faton Peci me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811557836 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Tropicana Club” D.O.O. Faton Peci Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811557836 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Tropicana Club” L.L.C. with owner Faton Peci with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811557836 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

